

Zgjidhja e një Enigme Institucionale: Çfarë Modeli të Institucionit Nacional për të Drejtat e Njeriut në Maqedoni

Ky prezantim i shkurtër është përgatitur në bazë të rezultateve të dy studimeve në kuadër të projektit "Zgjidhja e një Enigme Institucionale: Çfarë Modeli të Institucionit Nacional për të Drejtat e Njeriut në Maqedoni?" të realizuar nga QHBR (Qendra për Hulumtime dhe Bashkëpunim Rajonal) Studiorum gjatë periudhës 2011/2012: analizë kjo juridiko-politike me anë të së cilës është shqyrtuar vendosja aktuale institucionale krahasuar me standardet juridike ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut; dhe një studim krahasues i cili i kishte analizuar INDN-të nga Kroacia, Danimarka, Gjermania dhe Spanja. Rezultatet e fituara janë diskutuar nga një grup ekspertësh dhe do të botohen në formë të një studimi të vetëm që njëkohësisht i përfshin rekomandimet nga grupi i ekspertëve dhe përfundimet nga konferenca finale me fokus në INDN-të në rajon në përgjithësi dhe në Maqedoni në veçanti.

Arsyeshmëria

E Drejta Ndërkombëtare ofron një varg parimesh që kanë për qëllim t'i ndihmojnë shtetet në themelimin, pozicionimin dhe funksionimin e Institucioneve Nacionale për të Drejtat e Njeriut (INDN). Mes tjerash këtu përfshihen Parimet që kanë të bëjnë me Statusin e Institucioneve Nacionale – Parimet e Parisit (në nivel të OKB-së) dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për luftë kundër Racizmit dhe Jo-tolerancës (ECRI) në kuadër të Këshillit të Evropës. Këto standarde trajtojnë përbërjen, kompetencat, fuqitë statutores, transparencën, finasimin dhe garancat për pluralizëm të INDN-ve. Parimet e Parisit përdoren si kornizë në bazë të së cilës Komiteti Ndërkombëtar Koordinues (KNK) i Institucioneve Nacionale për Promovim dhe Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut i vlerëson INDN-të duke i akredituar ato në bazë të pajtueshmërisë së tyre me Parimet dhe duke u përshkruar atyre një numër të caktuar të drejtash dhe privilegjesh (p.sh. të marrin pjesë në mënyre aktive në sesionet e Këshillit për të Drejtat e Njeriut).

Deri në tetor të viti 2011 në Maqedoni nuk kishte asnjë INDN të akredituar nga KNK. Para pak kohësh, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, është akredituar me statusin "B", që do të thotë se "nuk është në pajtueshmëri të plotë" me Parimet e Parisit. Ky akreditim i nivelit "B" nuk ishte ndonjë befasi e madhe duke marrë parasysh përfundimet dhe rekomandimet paraprake për Maqedoninë të miratuara nga trupat monitoruese për të Drejtat e Njeriut e të cilat mes tjerash përfshinin edhe rekomandimin se vendi duhet të futet në një proces të reformave të vendosjes insitucionale me qëllim që të jetë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare (shih për shembull përfundimet e Rishikimit Periodik Univerzal të KB-së të vitit 2009 për Maqedoni apo raportin e vitit 2008 të Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut lidhur me të Drejtat e Njeriut në Maqedoni). Institucion tjetër i cili mund të kualifikohet si INDN në Maqedoni është Komisioni për Mbrojtje kundër Diskriminimit (KMKD). Krahasimi i punës së këtyre dy insitucioneve kundruall standardeve ndërkombëtare zbulon shumë mundësi për përmirësim.

Çka më tutje

Shumica e problemeve urgjente me të cilat ballafaqohen INDN-të në statusin e tyre të pikërishtë janë të ngjashme (promovimi i të Drejtave, përmirësimi i arsimimit, ngritja e vetëdijes, pluralizmi dhe standardet për zgjedhje, mungesa e mjeteve, etj). Edhe pse Avokati i Popullit paraqitet si më i avansuar sa i përket përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, një nga postulatet kryesore në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të Drejtave të Njeriut është se shteti asnjëherë nuk mund të

ketë numër të mjaftueshëm të mekanizmave dhe institucioneve për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Njeriut. Mund të shqyrtohen disa opsione për reformimin e kornizës momentale institucionale që INDN-të të jenë në vijë me standardet ndërkombëtare përmes zgjerimit të mandateve momentale, bartjes së plotë apo të pjesërishtme të kompetencave (nga një institucion në tjetër) apo bashkimit të institucioneve në një (si për shembull në Qendër për të Drejtat e Njeriut).

Për të pasur një qasje strategjike ndaj këtyre problemeve, duhet hapur një proces për konsultime publike lidhur me reformimin e kornizës institucionale për të Drejtat e Njeriut. Për t'u arritur kjo nevojitet vullneti i fortë politik dhe garanca të mjaftueshme kundër prapavajtjes. Një proces i tillë mund të jetë i gjatë, prandaj duhet shqyrtuar mundësia për ndryshime afatshkurtra dhe afatmesme, sidomos kur bëhet fjalë për mjetet, pavarësinë dhe pluralizmin e këtyre insitucioneve.

Komisioni për Mbrojtje kundër Diskriminimit

Komisioni për Mbrojtje kundër Diskriminimit i themeluar në bazë të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje kundër diskriminimit (2010) filloi të funksionojë në janar të vitit 2011 si organ i parë për barazi në Maqedoni.

Krahasuar me standardet ndërkombëtare pikat kryesore të përmirësimit të statusit të tij mund të identifikohen më poshtë:

Garancat për pluralizëm: të pamjaftueshme, meqenëse ato ekzistojnë në aspektin e pluralizmit etnik, mirëpo ato nuk sigurojnë që përmbajtja e KMKD-së të pasqyrojë diversitetin e shoqërisë si tërësi.

Anëtarësia: formulimi i kushteve për anëtarësim si “arsimim dhe përvojë në të Drejtat e Njeriut apo shkencë shoqërore” mundëson përzgjedhjen e anëtarëve pa aftësi dhe njohuri adekuate në lëmin e të Drejtave të Njeriut, barazisë dhe mbrojtjes kundër diskriminimit.

Kompetencat: mungesë e mandatit të qartë për të promovuar harmonizimin e legjislativës vendore në pajtueshmëri me standardet e të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut, për të inkurajuar ratifikimin e instrumenteve ose për të përcjellur implementimin e rekomandimeve nga organet monitoruese për të Drejtat e Njeriut relevante për barazi dhe mos-diskriminim, mungesë e mandatit të qartë për të inicuar apo asistuar edukimin formal dhe trajnimet profesionale; për t’ju ofruar informata dhe këshilla të gjithë faktorëve relevantë lidhur me temat mbrenda mandatit të tij; si dhe për monitorim të situatës së të drejtave të Njeriut në vend.

Bashkëpunimi: mungesë e mandatit të qartë për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Të qenurit i arritshëm: përkundër faktit se është parim operativ dhe themelor, të qenurit i arritshëm akoma paraqet një problem të pazgjidhur për KMKD-në sa i përket infrastrukturës, gjuhës etj.

Përgjegjësia dhe raportimi: Parlamenti nuk e ka obligim t’i diskutojë raportet vjetore të KMKD-së, ndërkaq që në rast të diskutimit të tillë Qeveria ekzekutive nuk ka obligim të merr pjesë në to.

Mjetet: KMKD nuk është në pozitë të negociojë për mjetet e veta meqë ato përcaktohen nga buxheti shtetëror, pra pavarësia financiare nuk është arritur.

Të gjitha çështjet e shtruara më lart paraqesin pengesë për pavarësi të plotë të KMKD-së.

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë është kategori kushtetuese (sipas Kushtetutës së vitit 1991) dhe Ligjit për Avokatin e Popullit (2003). Është themeluar në bazë të Ligjit paraprak në vitin 1997 dhe momentalisht ka statusin “B” nga ana e KNK-së.

Më poshtë janë të identifikuar pikat kryesore për përmirësim të institucionit:

Garancat për pluralizëm: nuk janë të parashikuara garancat për pluralizëm që e tejkalojnë përkatësinë etnike.

Anëtarësia: duhet ndryshuar procedura për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit/es së tij/saj përmes shqyrtimit të mundësisë për shpallje publike të pozitave në fjalë si dhe opcionin për një konsultim më të gjerë me shoqërinë civile dhe palëve tjera relevante në vend.

Kompetencat: ekziston nevoja për forcimin dhe zgjerimin e kompetencave veçanarisht në fushën e promovimit të të Drejtave të Njeriut, përfshirë këtu arsimimin formal dhe trajnimin profesional si dhe informimin dhe ngritjen e vetëdijes për të Drejtat e Njeriut. Me shumë kujdes duhet shqyrtuar zgjerimi i mandatit përtej sektorit publik dhe të drejtës vendore kah e Drejta Ndërkombëtare (monitorimi i rekomandimeve të ofruara nga organet e të Drejtave të Njeriut), natyrisht, nëse e gjithë kjo është e shoqëruar me mjete shtesë të mjaftueshme.

Bashkëpunimi: ekziston nevoja për përforcimin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, veçanarisht me organet e të Drejtave të Njeriut.

Mjetet: viteve të fundit është raportuar mungesë mjetesh, sidomos lidhur me Mekanizmin Nacional Parandalues.